

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË VLORE
NOTERE PUBLIKE FLORAXH.ZOTO
Nr. 3079 REP.Nr.1660 KOL

KONTRATË DHURIMI E KUOTAVE TË KAPITALIT

Në shoqërinë me Përgjegjësi të kufizuar

“FERRO GRUP” SHPK

Në Fier, sot me datë 27 Shtator . 2018, përpara meje noteres Flora Zoto, anëtare e Dhomës së Noterisë Fier, me seli në Rugen Dervish Hekali u paraqitën personalisht,

Palët e mëposhtme :

DHURUESI :

1- Aleksandro Ferro, atesia Miti, I datelindjes 06/05/1969, lindur në Fier e banues në Fier, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe për të vepruar identifikua prej meje noteres me leternjoftim Nr Personal: G90506026H date leshimi 26/01/2019, ortak në shoqëri « **FERRO GRUP** » Sh.p.k, me seli në Fier lagja BISHANAKE rruga Skenderbeu, ZK 8532, rregjistruar si person juridik dhe pajisur me Certificate rregjistrimi në organin tatimor **NIPT L82607406K**, zotërues i 1 kuote në kapitalin shoqëror të shoqërisë “FERRO GRUP” Shpk, e cila përfaqëson 33% të Kapitalit Shoqëror.

PRANUESI I DHURIMIT

Edlir Ferro, atesia Spiro shtetas shqiptar, i datelindjes 26/07/1985, lindur dhe banues në Fier, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar, identifikuar prej meje noteres me pasaporte numer BG6977222 dhe numer personal I50726019N date leshimi 06/10/2011.

Florenc Ferro, atesia Arqile, shtetas shqiptar, i datelindjes 06/08/1985, lindur dhe banues në Fier, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar, identifikuar prej meje noteres me leternjoftim numer 033562802 dhe numer personal I50809020E date leshimi 04/01/2018

Të cilët me vullnet të lirë e të plotë, më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate dhurimi kuotash në respektim të dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, si më poshtë:

Dhuruesi Aleksandro Ferro, është ortak zotërues i 1 kuote në Shoqërinë “Ferro Grup” shpk, e cila është një shoqëri tregtare shqiptare e regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar të Shoqërive Tregtare, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me datë 24/01/2018, me Nipt L82607406K

Nepermjet vendimit të datës 26. Shtator 2019 Asambleja e Ortakeve të shoqërisë “Ferro Grup” shpk, ka miratuar largimin e tij nga shoqëria dhe dhurimin e 1 kuote të zotëruar prej tij në shoqëri të cilat përfaqësojnë 33 % të kapitalit shoqëror në mënyrë të barabartë, favor të ortakeve të shoqërisë Edlir Ferro dhe Florenc Ferro.

Objekti i kontrates

Dhuruesi Aleksandro Ferro , i cili është nje prej ortakeve dhe zotërues i 1 kuote në shoqerinë “Ferro Grup ” Shpk **transferon nëpërmjet dhurimit** tërësisht këte kuote , me vullnet të lirë e të plotë, në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjit 9901 datë 14.04.2008 “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, i ndryshuar, Statutin e Shoqërisë dhe vendimit të Asamblese se Ortakeve të shoqërisë datë 26 Shtator 2019 , në menyre te barabarte ne favor të pranuesve te dhurimit , ortakeve Edlir Ferro dhe Florenc Ferro .

Garancitë

Pala Dhuruese deklaron dhe garanton pranuesin e dhurimit se është i vetmi titullar i ligjshëm i kuotes që po transferohet nëpërmjet kësaj kontrate dhe se ato janë të lira nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor.

Heqja dorë nga të drejtat

Dhuruesi Aleksandro Ferro deklaron nën pergjegjësinë e tij personale, se heq dorë nga nga te gjitha te drejtat që i takojne mbi zoterimin e 33 % te kapitalit ne shoqerine Ferro Grup „SHPK. .

Të ndryshme

Pas realizimit të këtij transferimi me nënshkrimin e kësaj kontrate, dhuruesi Aleksandro Ferro zhvishet teresisht nga zoterimi i 33 % te kapitalit te shoqerise Ferro Grup shpk , dhe *pranuesi i dhurimit* **Florenc Ferro** , bëhet zotërues i ligjshëm i 1 kuote e cila përfaqësonë 49.5 % te kapitalit të shoqërisë i përbërë nga kapitali i nënshkruar, asete të shoqërisë dhe merr përsipër çdo të drejtë dhe detyrim që i takon nga zotërimi i kësaj kuote në shoqerinë “Ferro Grup “ shpk. dhe *pranuesi i dhurimit* **Edlir Ferro** , bëhet zotërues i ligjshëm i 1 kuote e cila përfaqësonë 50.5 % te kapitalit të shoqërisë i përbërë nga kapitali i nënshkruar, asete të shoqërisë dhe merr përsipër çdo të drejtë dhe detyrim që i takon nga zotërimi i kësaj kuote në shoqerinë “Ferro Grup “ shpk.

Pjesët përbërëse të kontratës

Pjesët përbërëse të kësaj kontrate janë: *ekstrakti i shoqërisë “Ferro Grup ” shpk, fotokopjet e dokumentave identifikuese të palëve në këtë kontratë, vendimi i Asamblese se Ortaleve të shoqërisë.*

Kjo kontratë u hartua nga unë noterja në katër ekzemplarë me vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, dhe pasi shpreh vullnetin e lirë e të plotë të palëve në këtë kontratë, nënshkruhet regullisht sipas ligjit nga palet përpara meje dhe unë noterja vërtetoj rregullshmërinë e tyre.

DHURUESI

PRANUESI I DHURIMIT

Aleksandro Ferro

Florenc Ferro

NOTERE
FLORA XH. ZOTO

Edlir Ferro

Flora Xh. Zoto

Shoqëria "FERRO GRUP" Sh.p.k.

NIPT L82607406K

Selia, Fier, Lagja" Bishanak "Ruga "Skenderbeu "pallati Boshnjaku zona kadastrale 8532 kati i pare

VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

"FERRO GRUP" Sh.p.k.

Datë 26.SHTATOR .2019

Në Fier, sot me datën 26 .SHTATOR .2019, në selinë e shoqërisë, Asambleja e Ortakeve të shoqërisë "FERRO GRUP" Sh.p.k. zhvilloi mbledhjen sipas rendit të ditës në vijim:

RENDI I DITES:

- 1) Largimin nga shoqëria "FERRO GRUP" Shpk të ortakut të sa, Aleksandro Ferro , dhe dhurimin e kuotes të zotëruar prej tij në shoqëri, e cila përfaqësonë 33 % të kapitalit shoqëror të shoqërisë "FERRO GRUP" Shpk, në favor të ortakeve Edlir Ferro dhe Florenc Ferro
- 2) Dhurimin e 33 % të kapitalit të shoqërisë "FERRO GRUP" Shpk dhe transferimin e 1 kuote të zotëruar nga ortaku i shoqërisë z. Aleksandro Ferro në mënyrë të barabartë në favor të ortakeve të shoqërisë Edlir Ferro dhe Florenc Ferro.

Ortaku Aleksandro Ferro largohet nga shoqëria me vullnetin e tij të lirë dhe ka rënë dakort që kuota e zotëruar prej tij e cila përfaqësonë 33% të kapitalit të shoqërisë të përbërë nga kapitali i nënshkruar, të dhurohet në mënyrë të barabartë tek ortakët e mbetur të shoqërisë Edlir Ferro dhe Florenc Ferro , të cilët kanë shprehur vullnetin e tyre për të pranuar dhurimin e kesaj kuote duke trashëguar të gjithë kapitalin e nënshkruar të shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve , në respektim të statutit, Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" të ndryshuar me Ligjin Nr. 129/2014, Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar, Ligjit Nr.131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Legjislacionin Fiskal e Tatimor,

VENDOSI

- 1) Miratimin e largimit nga shoqëria "FERRO GRUP" Shpk të ortakut Aleksandro Ferro dhe dhurimin e 1(një) kuote të zotëruar prej tij , e cila përfaqësonë 33 % të kapitalit shoqëror të shoqërisë "Ferro Grup" Shpk, në mënyrë të barabartë tek ortakët e mbetur të Shoqërisë "Ferro Grup" shpk, z.Edlir Ferro dhe Florenc Ferro .
- 2) Dhurimin e 33 % të kapitalit të shoqërisë "Ferro Grup" Shpk dhe transferimin në mënyrë të barabartë e 1 kuote të zotëruar nga ortaku i shoqërisë z. Aleksandro Ferro , në favor të ortakeve : z.Florenc Ferro , dhe z.Edlir Ferro
- 3) Vendimi i mësipërm do të shoqërohet nga kontrata e dhurimit së kuotes sa më sipër.

Me nënshkrimin e këtij vendimi dhe kontratës së dhurimit së kuotave, ortake të shoqërisë "Ferro Grup" shpk mbeten Z.Florenc Ferro i cili bëhet zotëruar i 1 kuote , me vlerë të përgjithshme 5.050,000 lekë, të cilat përfaqësojnë 50.5% të kapitalit të shoqërisë, dhe Z.Edlir Ferro i cili bëhet zotëruar i 1 kuote , me vlerë të përgjithshme 4.950,000 lekë, të cilat përfaqësojnë 49.5% të kapitalit të shoqërisë.

Ngarkohet administratori i shoqërisë Edlir Ferro të depozitojë këtë vendim dhe kontratën e dhurimit së kuotave, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i tyre, për të reflektuar ndryshimet e mësipërme në skedën e shoqërisë sipas ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe

Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar me Ligjit Nr. 129/2014, Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” i ndryshuar, Ligjit Nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, me tejkalimin e këtij afati, shoqëria detyrohet të paguajë penaltitet të parashikuar nga ligji.

Vendimi i mësipërm është hartuar në gjuhën shqipe në katër ekzemplarë me vlera të njëjta juridike, dhe nënshkruhet rregullisht nga ortaku i shoqërisë “Ferro Grup” Shpk .

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE

Errenc Ferro



Albion Ferro



Edlin Ferro